



Titulli i projektit

Financim i studimit urbanistik për zhvillimin e zonës turistike pranë bregut të liqenit

Tipi i projektit

Zhvillim i qëndrueshëm i sektorit strategjik të turizmit, zhvillim i shërbimit publik të menaxhimit të territorit

Vendndodhja e projektit

Bregu i Liqenit të Shkodrës pranë Koplikut, Qendrës, Gruemirës e Kastratit

Buxheti i paravlerësuar

80,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Bazuar në informacionin e marrë nga banorët e zonës dhe grupet e interesit, peshkrimi dhe turizmi konsiderohen si fushat me aktivitet potencial për fshatrat përreth liqenit.

Për shkak të mungesës së eksperiencës dhe mungesës së të kuptuarit të tij, turizmi konsiderohet si zgjidhja e të gjitha problemeve ekonomike. Qasja e ndjekur deri më tani në bregdetin apo bregliqenin shqiptar karakterizohet nga mungesa e planifikimit dhe e forcës së ligjit, modeli laissez-faire i ndjekur për t'i dhënë shtysë ekonomisë, iniciativat private të filluara pa analiza të shëndosha të tregut. Kjo qasje ka prodhuar ndikime negative në mjedis dhe mos arritjen e rezultateve të dëshiruara ekonomike.

Për rrjedhojë, sfidat në lidhje me ndikimin e zhvillimeve ekonomike dhe urbane në liqen janë të mëdha. Zhvillimi i qëndrueshëm i zonës kërkon planifikim të kujdesshëm, bashkëpunim ndërmjet aktorëve për krijimin dhe nxitjen e burimeve alternative të të ardhurave dhe aktiviteteve ekonomike. Kjo nënkupton se mbrojtja e liqenit nuk mund të arrihet vetëm nga administrata e zonës së mbrojtur.

Nevojitet një qasje e qartë proaktive, bashkëpunuese dhe komunikuese për të garantuar që jo vetëm zhvillimet dhe aktivitetet ekonomike aktuale, por edhe ato të ardhshme, të mos ndikojnë negativisht në zonën e mbrojtur të liqenit.

Një studim urbanistik për zhvillimin e zonës turistike pranë liqenit, duke patur parasysh konceptin e zonimit ekonomik dhe zhvillimin e kujdesshëm të turizmit, do të përbënte drejtimin udhëheqës për aktorët vendimarrës në Zonën Funksionale Malësi e Madhe.

Qëllimi/et specifik të projektit

Objekti i projektit është hartimi i një plani urbanistik për zhvillimin e zonës turistike pranë liqenit, duke patur parasysh konceptin e zonimit ekonomik dhe zhvillimin e kujdesshëm të turizmit.

PROJEKTI 9



program i zonave funksionale

pzf

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

- Plan i hartuar për zhvillimin e bregut të liqenit;
- Çelje e rrugës për investime të mirë planifikuara;
- Shtim i numrit të aktiviteteve pranë bregut të liqenit;
- Shtim i numrit të vizitorëve;
- Shtim i gamës së shërbimeve dhe bizneseve;
- Rritje e të ardhurave;
- Vende të reja pune.

Aktivitetet e projektit

- Hartim i planit të zhvillimit urban.

Maturimi i projektit

Aktualisht nuk ekziston asnjë plan urban për zhvillimin e zonës verilindore të bregut të liqenit të Shkodrës. Studimi duhet të jetë pjesë e Planit Urbanistik të Zonës Funksionale Malësi e Madhe, por mund të ekzistojë edhe si studim i pjesshëm vetëm për zonën në fjalë, me qëllim që t'i hapet rrugë disa përmirësimeve në infrastrukturë, mjedis e shërbime.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

FZHR
FSHZH

Kostot e projektit

Kostoja e vlerësuar për një studim të planifikimit urban për një territor të tillë është 80,000 Euro.